

Projektet ndër vite nga departamentet e FIMIF

Departamenti i Kimisë

1. **“Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për degët inxhinierike në UPT”**, me krijimin e një laboratorit të kimisë, pranë FIMIF (2009-2011). Projekti është hartuar dhe realizuar, nën Kuadrin e Programit Kombëtar për "Barazinë dhe Cilësinë e Arsimit të Lartë".
2. **“Vlerësimi i ndotjes së mjedisit në një zonë urbane të lumit Lana, Tiranë” (2011-2012)**. Projekti është financuar nga Qeveria Shqiptare në kuadrin e Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit - "Për Kërkime Themelore dhe Ekselencë".
3. **“Vlerësimi i impaktit të veprimtarive ekonomike në cilësinë e ujrave të lumit Erzen”**, në bashkëpunim me Institutin e Ujrave të Universitetit Bujqësor të Vienës (Institute of Sanitary Engineering and Water Pollution Control, -University of Natural Resources and Life Sciences - BOKU) (2013-2014).
4. **“Një studim përfaqësues i sistemit të monitorimit të ujrave në Shqipëri. Vlerësimi i gjendjes dhe identifikimi i nevojave në këndvështrimin e Direktivave të Bashkimit Europian” (2015-2017)**. Ky projekt u mundësua në kuadër të Marrëveshjes bilaterale për Bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik midis Republikës së Shqipërisë dhe Austrisë dhe është financuar nga AKTI. Projekti është realizuar në bashkëpunim me Institutin e Ujrave të Universitetit Bujqësor të Vienës (BOKU)
5. **OpenLab ALBANIA, shkolla e parë e kristalografisë**, aktivitet që u zhvillua në datat 30 Maj – 3 Qershor 2016, në bashkëpunim me Institutin e Kristalografisë së Qendrës së Kërkimit Kombëtar në Itali
6. **“Sintetizimi dhe karakterizimi i nanomaterialeve të reja me qëllim përdorimin e tyre në restaurimin dhe mirëmbajtjen e fasadave të objekteve të klasifikuara si monumente kulturore” (2018-2020)**. Projekti është realizuar në bashkëpunim me FIM/UPT dhe nga pala italiane me CNR-IC Bari.

Departamenti i Inxhinierisë Fizike

1. Rrjeti Ndërkombëtar i Bashkëpunimit **“Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve”** 2013-2016 financuar nga DAAD, partner
2. Pjesëmarrja në Projekte Financuar nga AKKSHI” **Pajisje bashkohore kërkimore për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe integritet me industrinë e riciklimit të materialeve”** shtator 2019.

3. **“Vlerësimi i ndotjes elektromagnetike të mjedisit, në zonat urbane për frekuencat 900 MHz – 1800 MHz”**
4. **‘Matja e përqendrimit të gazit të radonit në zonat e ndryshme të Tiranës dhe krijimi i një sistemi hartash tematike si pjesë integrale për vizualimin e rezultateve të projektit”**
5. **“Studimi i potencialeve rajonale të energjisë diellore dhe energjisë së erës, ndjeshmërisë së efektivitetit të përdorimit të tyre nga parametrat fizikë e teknologjikë me metodat e analizës shumë faktoriale” 2013-2017**